

Shpallje për aplikim për staf akademik me kohë të plotë

Kolegji Universitar “Pavarësia Vlorë”, shpall aplikimet për vende të hapura pune për vitin akademik 2018 – 2019, për **staf akademik/pedagogë** me kohë të plotë, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, programet:

1. Drejtësi;
2. Shkenca Politike;
3. Ekonomi;
4. Inxhinieri Informatike;
5. Arkitekturë;

si dhe, **Kërkues Shkencorë** në Qendrat e Kërkimeve Shkencore.

Kandidati për pedagogë ose kërkues shkencor duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a. Të ketë përfunduar studimet universitare me mesatare mbi **8** (tetë);
- b. Të zotërojë titullin akademik “**Profesor**”, “**Profesor i Asociuar**”, ose të paktën, gradë shkencore “**Doktor**”;
- c. Të kenë eksperiencë pune në mësimdhënie, në pozicionin për të cilin aplikon;
- d. Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese;
- e. Të ketë njohuri të mira mbi Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në RSH”;
- f. Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze ose gjuhë tjetër të vendeve të BE-së;
- g. Njohuri të programeve bazë të kompjuterit.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, në Kolegjin Universitar “Pavarësia Vlorë”, dosjen e aplikimit me këto dokumente:

1. Kërkesa për punësim;
2. CV;
3. Diplomë e studimeve universitare dhe listë e notave, të noterizuar;
4. Letra rekomandimi nga pedagogë apo udhëheqës shkencorë, dhe të paktën një nga letrat të jetë nga punëdhënësi/drejtuuesi i fundit (nëse ka);
5. Fotokopje e dëshmimeve të kualifikimeve të ndryshme, të noterizuara;
6. Fotokopje e artikujve shkencorë të publikuar në revista kombëtare e ndërkombëtare, dhe/ose punime të tjera;
7. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
8. Fotokopje e librezës së punës (nëse ka);
9. Certifikatë e njohjes së gjuhës së huaj;
10. Certifikatë e përdorimit të programeve bazë të kompjuterit;

- Afati i aplikimit është deri më datë: **31 Korrik 2018**.
- Shqyrtimi i paketës së aplikimit do të bëhet brenda datës: **20 Shtator 2018**.
- Intervistimi i aplikantëve do të zhvillohet brenda datave: **25 - 30 Shtator 2018**.
- Shpallja e fituesve do të bëhet më datë: **05 Tetor 2018**.

Për çdo informacion mund të komunikoni në adresën: myzafer.elezi@unipavaresia.edu.al.

Ju faleminderit.